



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 15.4.2023

Nr: 367

Ora: 15:00

VENDIM  
PËR

**NDALIMIN E ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARIVE ME KARAKTER PUBLIK, TË BASHKISË TIRANË**

Sot më datë 15.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

**SUBJEKT:** Bashkia Tiranë

**OBJEKTI:** Ndalim i zhvillimit të veprimtarive me karakter publik, të raportuara nga Bashkia Tiranë

**BAZA LIGJORE:** Neni 19, pika 1, shkronja “n” dhe 2, neni 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator, “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”,

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**KONSTATOJ:**

Në datën 12.4.2023, Bashkia Tiranë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 2 (dy) veprimtari publike, me objekt:

1. “Event tematik me banorët e njesisë nr. 3, në kuadër të fushatës zgjedhore”, me pjesëmarrës: “Kryetari Bashkisë, deputeti dhe pjesëmarres të tjerë”, me vend zhvillimi: Njesia 3, me datë zhvillimi: 17.4.2023, ora 17.00
2. “Takim me Deputetët dhe Anëtarët e rinj të KB”, me pjesëmarrës “Kryetari i Bashkisë, deputeti dhe pjesëmarres të tjerë”, me vend zhvillimi: “Selia PS”, me datë zhvillimi 17.4.2023, ora 17:30.

Data: 15.4.2023 Nr: 367  
Ora: 15:00



“Për ndalimin e zhvillimit të veprimtarive me karakter publik të Bashkisë Tiranë”

Në datën 14.4.2023, Bashkia Tiranë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 6 (gjashtë) veprimtari publike, me objekt:

1. "Event tematik me banorët e njesisë nr. 8, në kuadër të fushatës zgjedhore", me pjesëmarrës: "Kryetari Bashkisë, deputeti dhe pjesëmarres të tjerë", me vend zhvillimi: Njesia 8, me datë zhvillimi: 19.4.2023, ora 18.00,
2. "Event tematik me banorët e njesisë nr. 12, në kuadër të fushatës zgjedhore", me pjesëmarrës: "Kryetari Bashkisë, deputeti dhe pjesëmarres të tjerë", me vend zhvillimi: Njesia 12, me datë zhvillimi: 19.4.2023, ora 18.00,
3. "Event tematik me banorët e njesisë nr. 13, në kuadër të fushatës zgjedhore", me pjesëmarrës: "Kryetari Bashkisë, deputeti dhe pjesëmarres të tjerë", me vend zhvillimi: Njesia 13, me datë zhvillimi: 20.4.2023, ora 18.00,
4. "Event tematik me banorët e njesisë nr. 14, në kuadër të fushatës zgjedhore", me pjesëmarrës: "Kryetari Bashkisë, deputeti dhe pjesëmarres të tjerë", me vend zhvillimi: Njesia 14, me datë zhvillimi: 21.4.2023, ora 16:30,
5. "Event tematik me banorët e Rrogzhinës dhe Kavajës, në kuadër të fushatës zgjedhore", me pjesëmarrës: "Kryetari Bashkisë, deputeti dhe pjesëmarres të tjerë", me vend zhvillimi: Kavajë, Rrogzhinë, me datë zhvillimi: 22.4.2023, ora 10.00,
6. "Event tematik me banorët e Kamzës dhe Vorës, në kuadër të fushatës zgjedhore", me pjesëmarrës: "Kryetari Bashkisë, deputeti dhe pjesëmarres të tjerë", me vend zhvillimi: Kamëz, Vorë, me datë zhvillimi: 22.4.2023, ora 17.00

Referuar nenit 92, pikat 1, 2 dhe 4, të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, parashikohet se institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Në rast se KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të të tretëve, konstaton nga informacioni, sipas pikës 3 të këtij neni, se veprimtaria mund të përbëjë keqpërdorim të burimeve shtetërore, atëherë ajo urdhëron ndalimin e zhvillimit të saj.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nga të dhënat e paraqitura në raportim ka konstatuar se, aktivitetet e raportuara nga institucioni publik, Bashkia Tiranë, me pjesëmarrjen e personave partiakë, në kuadër të fushatës zgjedhore, përbëjnë veprimtari të ndaluara, në kuptim të nenit 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja "n" dhe 2, nenin 92 pika 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të

Komisionit Rregullator, “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”,

## VENDOS:

1. Ndalimin e zhvillimit të veprimtarive publike me temë:
  - a) *“Event tematik me banorët e njesisë nr. 3, në kuadër të fushatës zgjedhore”, me vend zhvillimi: Njesia 3, me datë zhvillimi: 17.4.2023, ora 17.00,*
  - b) *“Takim me Deputetët dhe Anëtarët e rinj të KB”, me vend zhvillimi: “Selia PS”, me datë zhvillimi 17.4.2023, ora 17:30,*
  - c) *“Event tematik me banorët e njesisë nr. 8, në kuadër të fushatës zgjedhore”, me pjesëmarrës: “Kryetari Bashkisë, deputeti dhe pjesëmarrës të tjerë”, me vend zhvillimi: Njesia 8, me datë zhvillimi: 19.4.2023, ora 18.00,*
  - ç) *“Event tematik me banorët e njesisë nr. 12, në kuadër të fushatës zgjedhore”, me vend zhvillimi: Njesia 12, me datë zhvillimi: 19.4.2023, ora 18.00,*
  - d) *“Event tematik me banorët e njesisë nr. 13, në kuadër të fushatës zgjedhore”, me vend zhvillimi: Njesia 13, me datë zhvillimi: 20.4.2023, ora 18.00,*
  - dh) *“Event tematik me banorët e njesisë nr. 14, në kuadër të fushatës zgjedhore”, me vend zhvillimi: Njesia 14, me datë zhvillimi: 21.4.2023, ora 16:30,*
  - e) *“Event tematik me banorët e Rrogozhinës dhe Kavajës, në kuadër të fushatës zgjedhore”, me vend zhvillimi: Kavajë, Rrogozhinë, me datë zhvillimi: 22.4.2023, ora 10.00,*
  - ë) *“Event tematik me banorët e Kamzës dhe Vorës, në kuadër të fushatës zgjedhore”, me vend zhvillimi: Kamëz, Vorë, me datë zhvillimi: 22.4.2023, ora 17.00*
2. Njoftimin e Autoritetit të Mediave Audiovizive të mos lejojë transmetimin apo pasqyrimin në rubrikat e lajmeve apo ato që mbulojnë fushatën në radio dhe televizione.
3. Ky vendim i njoftohet palëve nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**